



**TË KRIJOJMË
SHPORTË
ARTIZANALE PREJ
THUPRE**

TOGETHER FOR LIFE

September, 2020



TË KRIJOJMË SHPORTË ARTIZANALE PREJ THUPRE

*S*hportat prej thupre të prodhuara në mënyrë artizanale janë produkte unike, shumë të preferuara dhe tepër miqësore me mjedisin. Shportat krijohen prej thupre prej shelgu, xunkthi apo bambuje. Disa prodhues e blejnë lëndën e parë, të tjerë e mbledhin në natyrë.

Nuk ka shtëpi pa një shportë, por të paktë janë ata që e dine se si krijohet një shportë. Këtu do të mësojmë se si prodhohet shporta dhe duket ndjekur hapat e mëposhtme do të mund të krijoni shportën tuaj të parë.




1 Thurja e fundit të shportës

*W*ë shportë fillon nga fundi i saj dhe ngjitet lart.

Endja, ashtu si tek tekstilet, është procesi i përgatitjes së bazës për thurje. Për një shportë me fund të sheshtë të rrumbullakët, baza fillohet duke krijuar fillimisht nyjen qendrore.

Thuprat e endjes për fundin e shportës (diskut) priten në varësi të madhësisë së shportës që do të bëjmë. Nëse dëshirojmë një shportë të vogël, atëherë thuprat duhet të jenë 20-25 cm. Për shportat mesatare përdoren thupra rreth 40-50 cm të gjata.

Për bazën e shportës mesatare do të zgjedhim 8 thupra me gjatësi 40 cm dhe diametër 7-8 mm secila. Katër thuprave u bëhet një prerje e tejpërtejme me thikë në mesin e gjatësisë, duke krijuar në 'vrimë' rreth 4-5 cm të gjatë në mes të çdo thupre.



VIZATIMI 1

Në vrimat e tejpërtejme të hapura në këtë mënyrë fusim katër thuprat e tjera. Thuprat e vendosura kështu, në formë kryqi (Vizatimi 1), përbëjnë bazën e endjes së fundit të shportës, mbi të cilin do të zhvillojmë procesin e thurjes me thuprat e thurjes.

Për thurjen zgjidhen 20-30 thupra të holla me diametër 2-3 mm dhe një gjatësi prej 50-100 cm.




Nëse thuprat nuk janë shumë të njoma dhe e kanë humbur elasticitetin, njomen paraprakisht në një govatë me ujë, ose me një sprucues për pak minuta. Lagia e thuprës bëhet gjatë gjithë proceseve të thurjes.



Nëse thuprat janë të trasha, i ndajmë në shirita me treshen (një shkop i shkurtër i trashë me tri kanale). Treshja vendoset në skajin e trashë të thuprës ku janë bërë më pare tri prerje të vogla. Me njërën dorë fiksohet skaji i trashë i thuprës dhe me dorën tjetër ushtrohet forcë mbi treshe, duke e shtyrë deri në fund të thuprës, e cila ndahet në tri shirita të barabartë.




Marrim një thupër thurjeje, skajin e hollë të së cilës e fiksojmë në të çarën e krijuar në thuprat e bazës dhe e mbajmë të shtrënguar aty me gishtat e njërës dorë.




VIZATIMI 2

Me dorën tjetër e kalojmë thuprën sipër dhe poshtë krahëve të 'kryqit', duke ardhur katër herë përqark nyjes qendrore. Kështu krijohen dy 'tegela' të plotë përreth nyjes si në Vizatimi 2.

Pastaj thuprat e 'kryqit' ndahen dy e nga dy. Thupra e thurjes kalohet poshtë e lartë dysheve të thuprave edhe katër herë të tjera përqark nyjes (shiko Vizatimi 3).



VIZATIMI 3



VIZATIMI 4

Më tej thuprat ndahen një e nga një dhe vazhdohet i njëjti proces, duke e kaluar thuprën e hollë poshtë dhe lart secilës prej thuprave të bazës. Tani modeli ka marrë pamjen e një dielli me 16 reze (Vizatimi 4).

Kur thupra e parë mbaron, merret thupra tjetër dhe vazhdohet thurja në të njëjtin vend, duke ndjekur radhën.

Thuprat e thurura ngjishen me duar fort drejt nyjes qendrore, me qëllim që punimi të dalë sa më i ngjeshur dhe solid. Mos u shqetësoni për majat thuprave që dalin dukshëm në të dyja anët e diskut. Ato do të priten kur fundi i shportës të mbarojë. Vazhdojmë thurjen derisa gjatësia e “rrezeve” që dalin nga disku i thurur të jetë 2-3 cm.

Gjatë thurjes sigurohemi që distanca midis thuprave të endjes të jetë e njëjtë dhe fundi i shportës të ketë pamjen e një një dielli me rreze simetrike dhe të baraslanguara. Thuprat duhet të punohen sa më ngjeshur të jetë e mundur për të mos krijuar hapësira në fundin e shportës.

Thurja me kujdes e fundit të shportës dhe cilësia e thuprave të përdorura do të jenë garanci për jetëgjatësinë e produktit në të ardhmen.


Disku i thurur kështu merret me të dyja duart dhe me gishtat e mëdhenj ushtrohet forcë në nyjen qendrore për t'i dhënë fundit të shportës një shmangie të lehtë konvekse, e cila është e nevojshme për stabilitetin e produktit të ardhshëm.

Tashmë fundi i shportës ka përfundur dhe do të fillojmë të thurim anët e saj.



2 Thurja e anëve / mureve të shportës

*A*shtu si me fundin e shportës, në fillim ngrejmë 'shtyllat' mbajtëse mbi të cilat do të ndërtojmë muret. Zgjedhim 16 thupra me diametër 3-4 mm dhe gjatësi rreth 50-60 cm. Njëën anë të thuprave e mprehim si majë lapsi dhe thuprat i fusim një e nga një, duke i shtyrë fort në 16 (kanalet) e krijuara nga thuprat e endjes në diskun e fundit të shportës.




VEGATINI S




Tani, me kujdes, thuprat i përkulim një e nga një në të njëjtin drejtim, në këndin 90° me bazën, si në Vizatimin 6.

Për të kthyer thuprat mund të përdorim edhe një pincë të hollë me majë rumbullakët.



VIZATIMI 6




VIZATIMI 9

Në mënyrë që të punohet më lehtë, majat e 16 thuprave lidhen së bashku 'xhufkë' me një fill elastic (Vizatimi 9) dhe në fund mund t'i vendoset një ngarkesë për të mbajtur të shtypur fundin e shportës.

Shumë artizanë fundin e shportës e fiksojnë me gozhdë në kallëpin përkatës dhe vazhdimin e punës për thurjen e mureve e vazhdojnë po aty.

Disa artizanë nuk përdorin as një rën, as tjetrën mënyrë, por thurin faqet anësore duke bërë kujdes që shporta të mos deformohet dhe e kontrollojnë dhe e sjellin në formën e duhur me duar herë pas here gjatë punës.




Por kjo aftësi sigurohet pas vitesh të tëra eksperiencë. Për fillestarët është me e këshillueshme të përdorin gurin e peshës ose kallëpin.


16 thuprat e diskut shërbejnë si bazë për thurjen e thuprave të tjera për të krijuar faqet anësore të shportës. Pasi të kemi përkulur të gjitha thuprat, marrim tri thupra të ndara më parë me treshe. Për përcaktimin e gjatësisë së thuprave të mureve anësore, në fillim matim perimetrin e shportës dhe e shumëzojmë atë me 1.5. Kjo është gjatësia ideale e thuprës së thurjes. Merrni tri thuprat e para dhe i ngulini njëra pas tjetrës në tri

thuprat e njëpasnjëshme të xhufkës, aty ku ato bashkohen me bazën e shportës nga ana e brendshme.

Thupra e parë majtas thuret, duke e kaluar nga jashtë thuprës pasardhëse dhe brenda thuprës tjetër dhe kështu me radhë. Ashtu thuren edhe thuprat e tjera, si në Vizatimin 7.




VIZATIMI 7



VIZATIMI 8

Në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtin drejtim me thuprën e parë gërshetohen 2 thuprat e tjera. Bëhet kujdes që thupra e dytë të thuret në mënyrë të tillë që nëse thupra e parë ka kaluar jashtë thuprës të endjes, kjo të kalojë nga brenda dhe anasjelltas, duke ndjekur logjikën e thurjes së fundit të shportës.

Teknika e përdorur për thurjen e mureve konsiderohet si "thurje e thjeshtë", që nënkupton gërshetimin e njëpasnjëshëm të thuprave përgjatë thuprave të endjes 'bishtalecit', sipas modelit të gërshetimit përpara-mbrapa (Vizatimi 10).



VIZATIMI 10




Në procesin e thurjes është e nevojshme të kontrollohet forma e produktit dhe të ruhet e njëjta distance midis thuprave të endjes, si në rastin e thurjes së fundit të shportës.

Me qëllim që muret anësore të jenë të ngjeshura dhe kompakte dhe me sa më pak hapësira mes thuprave të thurura, herë pas here, thurjet e realizuara i shtypim me gishta nga lart poshtë.

Pasi përfundon thurja e mureve anësore, modeli futet në vaskë me ujë që thuprat të rifitojnë elasticitetin e duhur për thurjen e bordurës së shportës.

Zgjidhim 'bishtalecin' dhe me thuprat e tij fillojmë thurjen e bordurës. Marrim thuprën e parë dhe e përkulim djathtas, duke e kaluar nga ana e brendshme të thuprës ngjitur me të, pastaj në pjesën e jashme të thuprës tjetër, njësoj si veprojmë me thurjen e thjeshtë. Veprojmë njësoj me thuprën e dytë që e kalojmë nga ana e brendshme e thuprës së tretë dhe nga jashtë

thuprës së katërt. Kështu i thurim me radhë një e nga një të 16 thuprat e 'bishtalecit'.



VIZATIMI 12

Në fund të thurjes, skajet e thuprave të endjes kthehen me pincë në buzën e thurur të shportës me drejtim nga poshtë. Skajet e gjata priten me një pincë ose gërshtë të posaçme sa më pranë thurjes (Vizatimi 12).





3 Thurja e dorezës

*T*hupra për dorezën zgjidhet të jetë më e trashë, më e fortë, më cilësore dhe më elastike, në mënyrë që të rezistojë sa më gjatë. Për bazën e dorezës thupra duhet të ketë një diametër 1.1-1.5 cm dhe gjatësi 55-60 cm.

Thuprën e lëmë për një kohë të gjatë në ujë që të zbutet dhe të bëhet elastike dhe me duar i japim një formë të harkuar.



VIZATIMI 12

Dy skajet e thuprës mprihen dhe bëhen me majë. Hapim paksa kanalim me bizë dhe fusim, duke e shtyrë me force, njërin skaj të thuprës (Vizatimi 12).

Në anën tjetër të diametrit të shportës gjejmë 'ullukun' e nëntë, duke filluar numërimin nga 1-shi tek 'ulluku' ku kemi futur njërin skaj të dorezës. Fusim skajin tjetër të thuprës (Vizatimi 13).


Thuprat e tjera të dorezës që do të mbështjellin thuprën kryesore janë të holla, me diametër 2-3 mm dhe 80-90 cm të gjata. Zgjedhim 8 thupra.



VIZATIMI 13

Merren katër thupra dhe futen një e nga në hapësirat pranë thuprës së parë. Edhe këto thupra janë lagur paraprakisht.


Pastaj fillon procesi i thurjes së dorezës. Thuprat mbështillen me duar dhe përdridhen fort rreth vetes sikur shtrydhim rrobat që të harkohen paksa, pastaj mbështillen përçark shkopit të dorezës 3-4 herë në formë spirale si në Vizatimin 14, deri në skajin tjetër të shportës. Skajet fundore të thuprave të holla futen një e nga një pranë thuprës së bazës si në Vizatimin 15.



VIZATIMI 15

Kështu veprojmë edhe me thuprat e tjera, të cilat i thurim katër e nga katër përgjatë bazës së dorezës. Nëse ka boshllëqe midis thuprave, atëherë futni 1-2 thupra shtesë.

Me qëllim që dy anët e dorezës të jenë më të forta dhe estetike, zgjidhen 5 thupra me diametër 2-3 mm dhe gjatësi 12-15 cm, të cilat lidhen si shall rreth dorezës në pikën ku ajo bashkohet me anët e shportës, si në Vizatimin 16.



VIZATIMI 16

Tashmë ju krijuat shportën tuaj të parë!



TË KRIJIMË SHPORTË ARTIZANALE PREJ THUPRE | Shtator 2020

